



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-118/02-16354
Datë 21.08.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 63 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) numër 13/2020 për Lirimin dhe Pensionimin e Parakohshëm nga Shërbimi Civil si dhe pas kërkesës me numër 01-118/02-16046 të parashtruar nga z. Shpend Krasniqi, me datë 21.08.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësit Shpend Krasniqi, i sistemuar në punë si Zyrtar Teknik i Pylltarisë në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **i lejohet pensionimi i parakohshëm nga data 01.09.2023;**
2. Pagesa për pensionim të parakohshëm është 70% e pagës bazë deri në moshën e pensionimit;
3. Pensionimi i parakohshëm i nëpunësit të shërbimit civil përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimi civil;
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A R S Y E T I M

Nëpunësi i shërbimit civil z. Shpend Krasniqi me datë 14.08.2023, përmes kërkesës me numër 01-118/02-16046 drejtuar Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka kërkuar që ti lejohet pensionimi i parakohshëm. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore brenda pesë (5) ditëve nga data e pranimit të kërkesës, ka verifikuar dhe konstatuar se nëpunësi Shpend Krasniqi e plotëson moshën për pensionim të parakohshëm dhe përmes postës elektronike zyrtare me datë 15.08.2023 e dërgon tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil për shqyrtim dhe dhënie të mendimit. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë brenda afatit ligjor prej dhjetë (10) ditëve nga data e pranimit të kërkesës nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, e ka shqyrtuar kërkesën dhe me datë 16.08.2023 ka dhënë mendim aprovues për të njëjtën. Pas marrjes së mendimit aprovues të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me datë 21.08.2023 kërkesën e nëpunësit së bashku me mendimin e mbikëqyrësit e dërgon tek udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit për aprovim. Udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit në përputhje me nenin 63 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) numër 13/2020 për Lirimin dhe Pensionimin e Parakohshëm nga Shërbimi Civil, brenda afatit ligjor prej 30 ditëve nxjerr këtë vendim lidhur me aprovimin e kërkesës së nëpunësit civil për pensionim të parakohshëm.

Bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i adresohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Shpend Krasniqi
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit



Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës